

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 36, datë 24.12.2021**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT  
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa, me këtë përmbajtje:

**Neni 1**

Në kreun XV “Dispozita tranzitore dhe të fundit”, pas pikës 7, të nenit “Dispozita kalimtare”, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

“8. Përjashtimisht parashikimeve në këtë ligj, zbatimi i sanksioneve për kundërvajtjet administrative që lidhen me zbatimin efektiv të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, do të fillojë të aplikohet pas datës 30.6.2022, për tatimpaguesit, si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, të cilët kryejnë vetëm shitje me para në dorë kundrejt konsumatorëve finalë, persona të patatueshëm;

b) tatimpaguesit që ofrojnë furnizimin me ujë për konsumatorët finalë, si dhe tregu i rregulluar i energjisë elektrike;

c) bankat apo institucionet financiare për njoftimin e pagesave të *e-Faturave* të lëshuara nga subjektet tatimpaguese.”.

**Neni 2**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**